

VENDIM
Nr. 242, datë 28.8.2026

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE PËR KËRKESËN E
SHOQËRISË “ALBPOWER” SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 40, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të neneve 4, pika 1, germa “e”, 5, pika 1, germa “e” dhe 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.8.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2586/1 prot., datë 26.8.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘AlbPower’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “AlbPower” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE nr. 2586 prot., datë 21.8.2026, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Nga shqyrtimi i aplikimit rezulton se ajo ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në nenin 9, për pikën 1.1, gjerat: “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gjerat: “a” “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gjerat “a”, “b”, si dhe pikën 2.5.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar rezulton se, në vijim të procedurës, shoqëria duhet të plotësojë aplikimin me dokumentacionin dhe informacionin, si më poshtë:

Neni 9. Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2. Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- germa “b”: Dëshminë e penaltetit të përditësuar për shoqërinë;

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- germa “c”: Sqarime dhe plotësime të planit të biznesit, lidhur me sasitë e energjisë elektrike të parashikuara për t’u tregtuar gjatë 5 (pesë) viteve në vijim.

Dokumentacioni i depozituar vlerësohet i mjaftueshëm për fillimin e procedurës administrative.

Në vijim të procedurës, shoqëria “AlbPower” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin dhe informacionin e sipërcituar, në përputhje me kërkesat e nenit 9, të rregullores së licencimit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën administrative për licencimin e shoqërisë “AlbPower” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Shoqëria “AlbPower” sh.p.k. të depozitojë në ERE, në vijim të procedurës, dokumentacionin dhe informacionin plotësues si më poshtë:

a) dëshminë e penalitetit të përditësuar për shoqërinë, në përputhje me nenin 9, pika 1.2, germa “b”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar.

b) planin e biznesit të plotësuar, në të cilin të evidentohen, për secilin nga 5 (pesë) vitet e parashikuara të ushtrimit të veprimtarisë, sasi të energjisë elektrike që shoqëria parashikon të tregtojë, të shprehura në mwh, në përputhje me nenin 9, pika 1.3, germa “c”, të rregullores së licencimit.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “AlbPower” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti